



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:917354
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05543219

C.nr.5866/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L.P, nga Prishtina, të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson B.O, avokat me seli në Prishtinë, kundër të paditurës K.... Sh.p.k., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson në bazë të autorizimit nga V.I, avokat me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulimin e vendimit, kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale, vlera e kontestit e pa përcaktuar, jashtë seancës gjyqësore, me dt.04.04.2024, mori dhe në të njejtën ditë përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË E PALEJUESHME padia e paditësit L.P, nga Prishtina, e cila evidentohet nën shenjë C.nr.5866/20, e parashtruar me datë 22.04.2010, kundër të paditurës K.... Sh.p.k., me seli në Prishtinë, lidhur me anulimin e vendimit, kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

A r s y e t i m

Paditësi L.P nga Prishtina, përmes përfaqësuesit të autorizuar, B.O, avokat me seli në Prishtinë, pranë kësaj Gjykate me dt.22.04.2010, ka parashtruar padi kundër të paditurës K.... Sh.p.k., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulimin e njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i datës 04.04.2010, kthimin në vendin e punës, si dhe kompensimin e pagave në mënyrë retroaktive. Kurse gjatë seancës së datës 25.05.2017, e ka bërë precizimin e padisë me të cilin ka kërkuar edhe anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i datës 25.05.2010. Në referatin e padisë ndër tjera pretendohet se paditësi me kontratën e datës 25.06.2007 ishte punësuar tek e paditura si bashkëpunëtor I jashtëm për tregun ndërtimor, kurse nga viti 2008 kishte kontratë me afat të pakufizuar. Ka shtuar se për shkak përformacës së mirë nga paditësi lidhur me përmbushjen e detyrimeve të punës, në vitin 2008 iu kishte ngritur paga për dhjetëra euro dhe atë 405.00 Euro paga neto, ndërsa me vendimin e datës 25.12.2009, përsëri iu kishte ngritur paga në shumën prej 538.00 Euro. Tutje pretendohet se e paditura, me datën 04.04.2010, ia kishte shkëputur kontratës me arsyetimin se paditësi nuk i kishte përmbushur detyrat e punës. Këtë ndërprerje të marrëdhënies së punës paditësi e ka konsideruar të pabazuar dhe të kundërligjshëm, me arsyetimin se nuk janë respektuar

procedurat për shkëputjen e kontratës të cilën e ka paraparë Rregullorja e UNMIKU-ut 2001/27 për Ligjin Themelore të Punës, Kontrata Kolektive dhe Ligjit për të Drejtat Themelore të Punës, specifikisht nenet 75 -83 dhe nenet 115-123 të Ligjit mbi marrëdhëniet e punës.

Gjykata, përmes aktvendimit procedural C.nr.856/10, të dt.30.09.2010, padinë me të gjitha shkresat e bashkangjitura ia ka dërguar të paditurës, në mënyrë që t'i ofrohet mundësia për paraqitjen e përgjigjes në padi brenda afatit prej 15 ditësh, në kuptim të dispozitës nga neni 395 par.1 të LPK-së.

E paditura, përmes përgjigjes në padi, të deponuar në Gjykatë me dt.19.11.2010, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se padia e paditësit duhet të hedhet si e palejuar ngase notifikimi për ndërprejen e marrëdhënies së punës nuk mund të atakohet në Gjykatë.

Çështja juridike në fjalë është kthyer dy herë në rigjykim dhe atë sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë AC.nr.1224/13, dt.09.02.2016 dhe së fundi me aktvendimin e po ashtu të kësaj Gjykate CA.nr.3391/17, dt.09.07.2020.

Pas kthimit të kësaj çështje juridike në rigjykim, Gjykata lidhur me këtë çështje ka mbajtur seancën përgatitore me dt.20.03.2024.

I autorizuari i paditësit av. B.O, gjatë seancës përgatitore ka deklaruar se mbetet në tërësi pran padisë të precizuar dhe ndryshuar dhe deklarimeve nga seancat e kaluara. Lidhur me pretendimet e të paditurës se padia është e palejuar ka theksuar se i kundërshtojnë me arsyetimin se padia është e afatshme, nuk është parashkruar kurse ndryshimi i saj është bërë brenda afatit ligjor respektivisht seancës përgatitore dhe për rrjedhim ligji nuk kërkon pëlqimin e palës tjetër. Ka shtuar se lidhur me këtë Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës sipas vendimin Rev.nr.53/2013, të datës 09.05.2013, është thënë shprehimisht se nëse punëtorit nuk iu është dhënë mundësia për mbrojtje brenda ndërmarrjes nuk mund ti mohohet e drejta për të parashtruar padi në Gjykatë në kuptim të lejueshmërisë. Ka theksuar se njoftimi i datës 04.04.2010 nuk ka patur këshillë juridike, ndërsa vendimi tjetër ishte nxjerr pasi kishin kaluar 1 muaj e 21 ditë nga data e nxjerrjes së njoftimit të datës 04.04.2010. Nga këto arsye ka vlerësuar se padia e paditësit është paraqitur brenda afatit ligjor.

I autorizuari i të paditurës av. V.I gjatë seancës përgatitore ka deklaruar se mbetet pran konstatimit se padia e paditësit është e palejuar. Ka theksuar se paditësi përmes padisë së datës 22.04.2010 e ka goditur njoftimin për qëllimin e shkëputjes së kontratës së datës 04.04.2010, i cili njoftim është nxjerr konform Rregullorës së UNMIK-ut, 1992/24, pasi e njëjta kishte paraparë nxjerrjen e një njoftimi të tillë para shkëputjes së kontratës. Gjykata lidhur me këtë padi pas përfundimit të seancës përgatitore dhe kryesor e ka hedhur si të palejueshme padinë e paditësit bazuar në nenin 83 të Ligjit për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës RSFJ.nr.60/1989, lidhur me rregulloren e UNMIK-ut 1999/24, me aktvendimin e kësaj Gjykate C.nr.856/10, dt.22.10.2012. Ka shtuar se gjatë kësaj procedure paditësi nuk ka kërkuar ndryshimin e padisë dhe edhe përkundër faktit se kundër aktvendimit në fjalë paditësi kishte ushtruar ankesë i njëjti nuk kishte kërkuar zgjerimin e kërkesëpadisë. Tutje ka shtuar se Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, me aktvendimin AC.nr.1224/13, dt.09.02.2016, e ka

kthyer në rigjykim këtë çështje juridike, kurse Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes aktvendimit C.nr.431/16 e ka hedhur sërish padinë e paditësit, pasi që e njëjta nuk e ka shqyrtuar ndryshimin e kërkesëpadisë të deklaruar në seancën e datës 25.05.2017. Tutje ka shtuar se ndryshimi i kërkesëpadisë i deklaruar në seancën e datës 25.05.2017 është e palejueshme në kuptim të nenit 257 të LPK-së, i cili përcakton se ndryshimi i padisë dhe kërkesëpadisë mund të bëhet vetëm në seancën përgatitore. Ka shtuar se paditësi nuk mundet në një çështje e cila është kthyer në rigjykim të kërkoj ndryshimin e kërkesëpadisë, pasi që seanca përgatitore lidhur me këtë padi kishte përfunduar në vitin 2010, prandaj ky ndryshim është i palejuar në kuptim të nenit 257 lidhur me nenin 11 të LPK-së. Po ashtu ka theksuar se parashtrimi i padisë me datën 25.05.2017, lidhur me vendimin për shkëputjen e kontratës 25.05.2010 është parashkruar, pasi që e njëjta është ushtruar jashtë afatit ligjor përkatësisht 7 vite më vonë. Nga këto arsye ka kërkuar nga Gjykata që si çështje paraprake fillimisht të vendoset lidhur me lejueshmërinë e padisë.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, sugjerimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës të dhëna përmes aktvendimeve AC.nr.1224/13, dt.09.02.2016 dhe CA.nr.3391/17, dt.09.07.2020, pretendimeve të paraqitura nga i autorizuari i paditësit dhe i autorizuari i të paditurës dhe ka ardhur në përfundim se padia e paditësit L.P , kundër të paditurës K.... Sh.p.k , me seli në Prishtinë, lidhur me anulimin e njoftimit të datës 04.04.2010, vendimit të datës 25.05.2010, kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale, duhet të hedhet poshtë si e palejuar.

Gjykata fillimisht sjellë në vëmendje se në konteste të natyrës së tillë gjegjësisht kontesteve të punës, është e domosdoshme që në çdo fazë të procedurës të përqendrohet në vlerësimin e faktit nëse janë përmbushur dy parakushte apo prezumime bazë: 1) që i punësuar – paditësi, para se të kërkojë realizimin e të drejtës së pretenduar në rrugë gjyqësore, paraprakisht i ka shfrytëzuar procedurat interne pranë punëdhënësit dhe 2) nëse padia është dorëzuar brenda afateve të përcaktuara me ligj. Prezumimet në fjalë duhet përmbushur në mënyrë kumulative, në mënyrë që të ofrohet mbrojtje gjyqësore lidhur me të drejtat e pretenduara që burojnë nga marrdhënia e punës.

Në funksion të këtij vlerësimi, referuar natyrës dhe periudhës kur është krijuar raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse, Gjykata iu referua Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrdhënia e Punës (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr.60/1989), i cili ka qenë ligj i zbatueshëm në Kosovës sipas Rregullorës së UNMIK-ut, nr.1999/24. Dispozita nga neni 83 e këtij ligji parasheh: "*Punëtori i cili nuk është i kënaqur me vendimin definitive të organit kompetent në organizatë apo nëse ky organ nuk merr vendim në afat prej 30 ditësh, nga data e paraqitjes së kërkesës gjegjësisht kundërshtimit ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh ta kërkojë mbrojtjen e të drejtave të veta para gjykatës kompetente.*" Kurse me par.2 të po këtij neni parashihet shprehimisht: "*Mbrojtja e të drejtave para Gjykatës kompetente nuk mund ta kërkojë punëtori i cili paraprakisht nuk ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave para organit kompetent të organizatës, për veç të drejtave për kërkesat në të holla.*"

Në rastin konkret, nga thëniet e paditësit në padi si dhe seancë përgatitore, e në ndërlidhje me provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, Gjykatës i rezulton se veprimi i parë i të paditurës, me të cilin pretendohet që paditësit i janë shkelur të drejtat nga marrdhënia e punës, është materializuar përmes notifikimit për qëllimin e shkëputjes së kontratës të datës

04.04.2010, akt ky të cilin pala paditëse e ka kontestuar me padinë e datës 22.04.2010, duke e kërkuar edhe anulimin e të njejtit në petitum të kërkesëpadisë. Kurse gjatë seancës përgatitore të datës 25.05.2017, i autorizuari i paditësit ka bërë zgjerimin e kërkesëpadisë edhe në drejtim të anulimit të vendimit të datës 25.05.2010 për shkëputjen e kontratës së punës së paditësit, i cili ndryshim i padisë është lejuar sipas aktvendimit të kësaj Gjykate me datën 20.03.2024.

Pas pranimit të notifikimit për qëllimin e shkëputjes së kontratës të datës 04.04.2010, në bazë të provave materiale të cilat gjenden në dispozicion në shkresat e lëndës, Gjykatës i rezulton se paditësi nuk ka paraqitur fare kërkesë tek pala e paditur lidhur me shkeljen e pretenduar, duke mos e konsumuar në këtë mënyrë të drejtën e garantuar me dispozitën e lartëcekur nga neni 83 par.1 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr.60/1989), i cili ka qenë ligj i zbatueshëm në Kosovës sipas Rregullorës së UNMIK-ut, nr.1999/24, e cila dispozitë referohet shfrytëzimit të mjeteve interne pranë punëdhënësit. I njejtë ka paraqitur drejtpërdrejtë padi në gjykatë me dt.22.04.2010. Si pasojë e një lëshimi të tillë, meqenëse nuk përmbushet parakushti i parë, Gjykata nuk mund të lëshohet në vlerësimin e faktit nëse ka ardhur në shprehje edhe plotësimi i parakushtit të dytë, që ka të bëjë me parashtrimin e padisë brenda afatit të përcaktuar me dispozitën nga neni 83 i Ligjit në fjalë, në raport me anulimin e notifikimit për qëllimin e shkëputjes së kontratës së datës 04.04.2010.

Gjykata vlerëson se edhe përkundër faktit se notifikimi për qëllimin e shkëputjes së kontratës i datës 04.04.2010, nuk e ka patur këshillën juridike, i njëjti pavarësisht kësaj e ka patur obligim që sipas dispozitës së nenit 83 par.1 të Ligjit në fjalë të ushtroj ankesë tek punëdhënësi, sepse dispozita e nenit 83 par.2 të ligjit në fjalë në mënyrë shprehimore përcakton se punëtori nuk mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij para Gjykatës i cili paraprakisht nuk ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave para organit kompetent të organizatës.

Ky vlerësim i Gjykatës gjen mbështetje edhe në qëndrimet e shprehura nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës përmes Përmbledhjes nga Praktika e Gjykatës Supreme në Çështje Penale dhe Civile, Prishtinë, 2023, gjegjësisht në kapitullin VII - Kontestet e punës, shqyrtimi paraprak i padisë, afati për paraqitjen/lejueshmërinë e padisë si prezumim procedural. Gjegjësisht në faqen 501 të kësaj përmbledhje, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, shprehimisht potencon: *“Pra, i punësuari nuk mund ta kërkojë mbrojtje gjyqësore sa i përket të drejtave nga marrëdhënia e punës, pa i shterur paraprakisht procedurat interne (mjetet e brendshme).”*

Në anën tjetër Gjykata vlerëson se padia e paditësit e zgjeruar gjatë seancës së datës 25.05.2017 lidhur me anulimin e vendimit të datës 25.05.2010, për shkëputjen e kontratës së punës, është parashtruar pas kalimit të çdo afati ligjor të paraparë në dispozitën e nenit 83 të Ligjit të sipërcituar.

Nga deklarimi i të autorizuarit të paditësit L.P , av.B.O, në seancën përgatitore e datës 20.03.2024, vërtetohet se paditësi vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i datës 25.05.2010, e ka pranuar me datën 27.05.2010, kurse zgjerimin e padisë në raport me anulimin e këtij vendimi e ka bërë gjatë seancës së datës 25.05.2017, që nënkupton se një gjë të tillë e ka

bërë pas kalimit të po thuajse 7 viteve nga data e pranimit të vendimit në fjalë. Edhe përkundër faktit se i njëjti ka qenë i udhëzuar të ushtrojë ankesë – padi në Gjykatë kundër këtij vendimi, i njëjti një gjë të tillë nuk e ka bërë brenda afateve të përcaktuara në dispozitën e nenit 83 të Ligjit të cekur më lartë. Në këtë kuptim Gjykata vlerëson se kërkesa për anulimin e vendimit të datës 25.05.2010, nuk ka mundur ta trajtohet si kërkesë të paraqitur me padinë e datës 22.04.2010, ngase padia në raport me këtë vendim është zgjeruar me datën 25.05.2017, dhe për Gjykatën kjo paraqet zgjerim të kërkesëpadsisë krahasa asaj ekzistuese, konkretisht kërkesë të re, të cilën sa i përket lejueshmërisë së saj duhet të trajtohet nga momenti i paraqitjes – zgjerimit të së njëjtës.

Bazuar në këto rrethana, vlerësimi i Gjykatës konsiston në faktin se padia e ushtruar në këtë çështje juridike rezulton të jetë e parakohshme në raport me anulimin e nofitikimit për qëllimin e shkëputjes së kontratës së datës 04.04.2010 dhe e jashtë afatshme në raport me anulimin e vendimit të datës 25.05.2010, për shkëputjen e kontratës së punës, që rrjedhimisht nënkupton se paditësi nuk e ka fituar të drejtën që të kërkojë realizimin e të drejtës së pretenduar nga marrdhënia e punës përmes rrugëve gjyqësore.

Si përfundim, në një situatë të tillë, Gjykata nuk ka tagër që të procedojë me vlerësimin e pretendimeve që kanë të bëjnë me themelësinë e kërkesëpadsisë, pasi në këtë fazë të procedurës, padia duhet hedhur poshtë si e palejueshme, në kuptim të dispozitës së nenit 391 pika f) e LPK-së, e cila përcakton: "*Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedhë poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj*".

Gjykata mori parasysh faktin se dispozita e lartëcekur i referohet veprimeve të ndërmarra pas shqyrtimit paraprak të padisë, ndërsa kjo çështje kontestimore ndodhet në fazën e shqyrtimit përgatitor. Megjithatë, duhet vënë në dukje faktin se lidhur me prezumimet procedurale të llojit dhe karakterit të tillë në konteste të kësaj natyre, Gjykata duhet të kujdeset gjatë gjithë procedurës, nënkuptohet në mbështetje të vlerësimit të provave të cilat gjenden në dispozicion në shkresat e lëndës. Për më tepër kjo çështje sa i përket shqyrtimit paraprak të padisë kur Gjykata nuk ka material të mjaftueshëm procedural, është rregulluar edhe me dispozitën e nenit 393 të LPK-së në të cilën përcaktohet: "*Gjykata, në qoftë se konsideron se nuk ka material procedural të mjaftueshëm për dhënien e aktvendimit mbi ndonjë çështje që është paraqitur gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, do të vendosë lidhur me të pasi të arrijë përgjigja në padi e të paditurit ose gjatë seancës përgatitore apo në seancën për shqyrtim kryesor të çështjes, po që se nuk është mbajtur seanca përgatitore*". Andaj, në prezencën e konstatimeve se pala e cila ka parashtruar padinë, respektivisht ka kërkuar mbrojtje gjyqësore, ka bërë lëshime të cilat janë elaboruar më gjerësisht në pjesën e mësipërme të këtij aktvendimi, Gjykata nuk mund të lëshohet në vlerësim në merita të pretendimeve të cilat i përkasin themelësisë së kërkesëpadsisë, për faktin se veprimet e tilla do të konsistojnë në shmangie nga dispozitat ligjore të aplikueshme.

Bazuar në këto arsye, e në kuptim të dispozitave të lartëcekura, Gjykata vendosi decidivisht si në dispozitivin e këtij aktvendimi, në atë mënyrë që është hedhur poshtë si e palejueshme padia e paditësit L.P , e cila evidentohet nën shenjë C.nr.5866/20, e parashtruar me datë 22.04.2010,

kundër të paditurës K.... Sh.p.k, , me seli në Prishtinë, lidhur me anulimin e vendimit, kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, nga pika II e dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 450 lidhur me nenin 463 të LPK-së, bazuar në faktin se ky kontest ka përfunduar në dëm të palës paditëse, e në anën tjetër pala e paditur, as me përgjegje në padi e as gjatë seancës së fundit nuk i ka kërkuar dhe nuk i ka specifikuar të shpenzimet e procedurës kontestimore, në kuptim të dispozitës nga neni 463 të LPK-së. Mbi këtë bazë, vendosi që secila palë duhet t'i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

Mbi bazën e të lartëcekurave, u vendos decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil-
C.nr.5866/20, datë 04.04.2024

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.